



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR SHPRONËSIMIN  
KOMISIONI I POSAÇËM I SHPRONËSIMIT DHE/ OSE SHKËMBIMIT

Nr. 401 Prot.

Tiranë, më 30.06.2022

Lënda: 13 Njoftim për shpronësim dhe/ ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik.

**VIOLETA RAMIZ BAKALLI**

**BASHKISË DURRËS**

Adresa: Sheshi "Liria", 2000 ✓

Durrës

**FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

Rruga: Sami Frashëri, Nr. 10,

Tiranë

Bazuar në pikën 13, kreu I, të Vendimit nr.7, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe / ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit", i ndryshuar, Ju njoftojmë se:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit bazuar në pikën 5, të Vendimit nr. 7, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, me shkresën nr. 1050 prot., datë 08.04.2022, protokolluar në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin (ASHSH) me nr. 401 datë 08.04.2022, ka kërkuar shpronësimin dhe/ ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën e planifikuar për rindërtim sipas planit të detyruar vendor për zonën e dëmtuar pikësore për 5 banesa kolektive, në Bashkinë Durrës, miratuar me Vendimin nr. 596, datë 30.09.2020 të Bashkisë Durrës.

Vlerësimi i pasurisë të llojit "godinë banimi", është llogaritur bazuar në çmimin mesatar të shit-blerjeve për objekte banimi për tre muajt e fundit, konfirmuar nga ASHK Durrës me shkresën nr. 1496/1 dt. 28.03.2022, konkretisht për sipërfaqen  $89 \text{ m}^2 \times 68,750 \text{ lekë/ m}^2 = 6,118,750 \text{ lekë}$ ;

Vlerësimi për pasurinë e llojit "truall", është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", konkretisht për sipërfaqen  $89 \text{ m}^2 \times 12,945 \text{ lekë/ m}^2 = 1,152,105 \text{ lekë}$ ;

**Vlera totale paraprake e shpronësimit është = 7,270,855 lekë**

Sa më sipër, si dhe referuar kartelës së pasurisë të datës 28.06.2022, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Durrës dhe protokolluar në ASHSH me nr. 401/17 prot., datë 30.06.2022, Ju do të shpronësoheni dhe/ ose do të kompensoheni nga shkëmbimi i pasurisë Tuaj të paluajtshme, pronë private numër 5/672, lloji "truall+ godinë banimi", ZK. 8513, sipas kriterëve të përcaktuara në

Vendimit nr.7, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kushtet dhe procedurën për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Referuar pikes 15, të kreu I, të Vendimit nr.7, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja dijani, të paraqitni pretendimet Tuaja nëse keni, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Durrës, si dhe në ASHSH, duke u shprehur nëse pranoi kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Në mungesë të adresës së pronarit të shpronësuar, kërkojmë nga ana e Bashkisë Durrës, marrjen e masave për njoftim.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**KRYETAR  
I KOMISIONIT TË POSAÇËM  
TË SHPRONËSIMIT DHE/ OSE SHKËMBIMIT**

**Erlis Hereni**

